

BAJAZIT M. SHEHU

(1924- 1991)

BAJRAMI Z.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Biologjisë.

Nuk njoh ndonjë ish student dhe koleg të profesor Bajazit Shehut që të mos ketë shfaqur veçse respekt dhe mirënjohje ndaj tij. Kam bindjen se jeta dhe puna e tij është shembull në të mirë të mendimit se më shumë se kushdo tjetër janë ata fëmijët, nxënësit dhe studentët që nuhasin dhe ndjejnë nga larg njeriun e mirë, fisnik dhe zemërgjerë.

Fillimisht për këto ndjesi dhe konsiderata kam bërë përgjigjës faktin se profesorit i dridhej dora që të shënonte një notë negative në librezën e studentit. Por e vërteta, të cilën e mësova më vonë kur u bëra koleg dhe mik i tij, ishte krejt e ndryshme.



Bajazit Shehu për një kohë relativisht të gjatë zhvilloi leksione të Fiziologjisë Shtazore, Anatomisë, Biologjisë së Përgjithshme, Histologjisë, Citologjisë, Gjenetikës, dhe Teorisë së Evolucionit. A nuk të bën përshtypje numri i madh i disiplinave biologjike? Sa leksione ka marrë përsipër profesori ynë? Ndokush e kërkon shkakun e kësaj ngarkese tek nevojat urgjente të stadeve fillestare të punës në katedra. Por realisht katedrat e Biologjisë së asaj kohe, d.m.th. katedrat e Botanikës dhe Zoologjisë, e kishin kaluar stadin e nevojës për profesorë, sepse tashmë ishte grumbulluar përvojë 10-15 vjeçare. Megjithatë jetohej një nevojë tjetër. Ishte koha kur në Botë shkencave biologjike ju kërkohesh të përballonin sfida ndryshimesh thelbësore. Natyrisht edhe tek ne dikush do të mbante mbi shpatulla përgjegjësinë për ndryshimet e domosdoshme në degën e biologjisë. Kjo përgjegjësi që mori përsipër profesor Bajazit Shehu e gjeti shprehjen e saj në futjen e lëndëve të reja dhe në

përmirësimin e planeve dhe programeve ekzistuese. Kjo përgjegjësi intelektuale që mori përsipër e gjeti shprehjen e saj në punën e tij entuziaste.

Entuziazmi i tij lexohej në çdo orë të leksioneve dhe në çdo bisedë me të. Këtë entuziazëm, pa të cilin nuk bëhet asgjë e bukur, Bajazit Shehu e mbillte dhe e rrënjoste në mendjen e çdo studenti. Ishte ky entuziazëm që përthithte çdo student prej tij, rrjedhojë e të cilit ishte respekti dhe dashuria që ushqenin studentët për të. Jo rrallë, e harrojmë këtë burim respekti të studentëve ndaj profesorit. Harrojmë që kur studentët futen në botën e dijes, preferojnë profesorët që dinë të shuajnë etjen e tyre. Në këto rrethana, jo çdo njëri prej nesh arrin të përmbushë rolin e vështirë të profesorit, sepse për këtë rol kërkohet pasioni për dijet dhe dashuria për studentët, dy gjëra këto që i zotëronte profesor Bajazit Shehu. Një miku i tij na thoshte se po ta shikonim profesorin qoftë edhe njëherë pa libër në dorë, ai do të na gostiste me çfarë të donim. Personalisht pasionin e tij për librin e kam njohur nga afër sepse shpesh më qëllonte ta shoqëroja jo vetëm në bibliotekat e Universitetit dhe Akademisë, por deri në ato të institucioneve të ndryshme. Me këtë 'ves' ai infektonte edhe studentët e tij.

Bajazit Shehun në vitin 1924, në moshën dy javëshe, e kishte marrë i jati në Itali, sepse ishte internuar dhe dënuar me vdekje nga Zogu. Kur u kthye nga Italia në vitin 1937 ai vazhdoi shkollën e mesme në Liceun e Korçës. Më vonë filloi studimet në Universitetin e Zagrebit, të cilat i mbaroi në Universitetin e Odesës, në degën e Biologjisë. Kjo kishte bërë që ai të njihje shumë gjuhë të huaja, si italisht, frëngjisht, serbo-kroatisht, rusisht. Rreth viteve 50-të filloi punë në Institutin Bujqësor, e pastaj në vitin 1961 në Universitetin e Tiranës, ku ai mësoi gjuhën angleze dhe gjermane.

Pa dyshim në se ka një veçori të cilin kam dashur gjithmonë ta imitoj nga profesori, kjo është sjellja dashamirëse dhe prindërore ndaj studentëve. Ai që në pamjen e parë dukej kaq i rëndë dhe indiferent kishte në të vërtetë një zemër tepër bujare dhe fisnike. Këtë zemër besoj se e kanë njohur ish studentët dhe më vonë bashkëpunorët e tij më të ngushtë si E. Ruka, T. Rexha, L. Memushi etj. Një ditë po i tregoja një ushtrim nga Gjenetika e Popullatave; më mburri duke thënë se ai nuk do ta zgjidhte dot vetë këtë ushtrim. Në të vërtetë po atë ditë e pashë këtë ushtrim të zgjidhur në fletoren e tij. Sjelljet e tij ishin të tilla që studentët dhe bashkëpunorët të ndjeheshin mirë e të sigurtë me dijet e përfuara dhe të bëheshin kurajozë në kërkimin e tyre.

Në vitet `80-të, Bajazit Shehu punoi në Shtëpinë Botuese 'N. Frashëri'. Ky profesion i ri, ndonëse i kushtëzuar nga qarkullimet e njohura të asaj kohe dhe kundër dëshirës së tij, solli si produkt anësor një kontribut tjetër të veçantë të

tij: botimin e një liste të gjatë të librave me vlerë në fushën e biologjisë. Në këtë mënyrë, tregohet edhe një herë se njeriu është ai që e bën profesioni dhe jo e kundërta. Botimet që ai diti aq mirë t'i përzgjithte me kujdes, ishin meritë tjetër e B. Shehut. Gjatë kësaj kohe ai hartoi disa tekste mësimore: Fiziologjia Shtazore, Gjenetika, Biologjia e Përgjithshme etj.; ndoshta po aq e madhe është merita e tij edhe në përkthimin dhe përshtatjen e librave bazë të biologjisë, lista e të cilave është e gjatë.

Aq sa u tha më sipër përfaqëson vetëm atë që mbetet prej një vështrimi vetëtimthi për jetën e Bajazit Shehut ... dhe ia vlen të shkruhet gjithmonë për profesorë si ai, për profesorët e vërtetë.